

PLANI PËR INTEGRITET

2023 - 2026

KOMUNA E GJAKOVËS

DRAFT

2022, Gjakovë

Përbajtja

1.	Hyrja	3
2.	Deklarata për Integritet	4
3.	Parimet e menaxhimit të Integritetit	6
3.1	Lidershipi	6
3.2	Përfshirja e personelit	6
3.3	Qasja sistemore	7
4.	Objektivat e Planit të Integritetit	7
5.	Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit	8
5.1	Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit	8
5.1	Metodologjia e vlerësimit të rrezikut	9
7.1.1	Matrica vlerësimit të rrezikut	9
7.1.2	Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut	10
6.	Monitorimit i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi	11
7.	Fushat e rrezikut	14
7.1	Fushat e përgjithshme të Rrezikut	14
7.1.1	Drejtimi dhe menaxhimi	14
7.1.2	Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve	14
7.1.3	Planifikimi dhe menaxhimi financiar	14
7.1.4	Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumenteve	14
7.2	Fushat e veçanta të rrezikut	14
7.2.1	Auditimi i Brendshëm	14
7.2.2	Prokurimi publik	14
7.2.3	Zhvillimi ekonomik lokal	14
7.2.4	Planifikimi urban dhe rural	14
7.2.5	Standardet e ndërtimit dhe kontrolli	14
7.2.6	Inspektimet	14
7.2.7	Arsimi Publik	14
7.2.8	Shëndeti publik	14
7.2.9	Licencimi i shërbimeve	14
7.2.10	Mirëmbajtja e rrugëve dhe e parqeve	Error! Bookmark not defined.

1. Hyrja

Në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe "Strategjinë Shtetërore Kundër Korrupsionit" të cilat obligojnë të gjitha institucionet të zhvillojnë dhe miratojnë planet e integritetit, Komuna e Gjakovës, harton dhe miraton Planin e Integritetit për periudhën 2023 -2026.

Plani i integritetit është një mjet përvendosjen dhe verifikimin e integritetit të organizatës dhe është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e ceneshmërisë së një organizate dhe ekspozimin e saj ndaj praktikave jo etike dhe të korrupsionit. Plani është dokument operativ, që ofron masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të komunës. Plani rithekson përkushtimin e komunës për të shtuar dhe fuqizuar kontrolllet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve efikase, transparente dhe të orientuar kah klienti. Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arrijen e objektivave të komunës dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standarde profesionale.

Plani i integritetit mundëson:

- Identifikimin e rreziqeve përkatëse të korrupsionit në fusha të ndryshme të punës në një organizatë individuale;
- Vlerësimin e çfarëdo lloj rreziku që mund të paraqes rrezik për shfaqjen e korrupsionit për një organizatë individuale; dhe
- Përcaktimin e masave për të zvogëluar ose eliminuar rreziqet e korrupsionit.

Plani i Integritetit pritet të kontribuojë në mënyrë domethënëse në:

- Rritjen e mundësive që Komuna të arrijë objektivat e sajës organizative duke vënë përpara një menaxhim pro-aktiv të rrezikut të integritetit. Kjo do të përmirësojë rezistencën organizative ndaj korrupsionit dhe do të zvogëlojë/eliminojë mundësitë për korruption.
- Përqendrimin tek prioritetet, në bazë të identifikimit dhe vlerësimit të rrezikut që do ta ndihmojnë komunën të shpërndajë në mënyrë efektive burimet e disponueshme kundër korrupsionit në mënyrë që të shfrytëzohen në mënyrën më mirë të mundshme;

- Përmirësimin e kontrolleve operacionale ndaj shkeljeve të integritetit që do të rrisin efektivitetin, efikasitetin dhe transparencën e të gjitha proceseve, përfshirë ofrimin e shërbimeve;
- Mbajtjen e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet përkatëse ligjore dhe procedurale;
- Krijimin e një mjedisi të brendshëm të favorshëm kundër korruption përmes trajnimit të synuar dhe ndërgjegjësimit, si dhe duke inkurajuar një bashkëpronësi të të gjithë stafit në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të planeve të integritetit;
- Rritjen e mëtejshme të besimit të palëve të brendshme dhe të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstrohet nga Komuna.

Me zbatimin e këtij Plani, komuna do të jetë në pozitë më të mirë për të siguruar efikasitet, efektivitet, transparencë dhe etikë gjatë arritjes së rezultateve të synuara, përfshirë këtu shërbimet më të përmirësuara për publikun dhe rritje të kënaqshme nga ana e palëve të interesuara. Plani mbështetet në rezultatet e një planifikimi gjithëpërfshirës për integritetin dhe të një procesi të vlerësimit të rrezikut të bërë nga komuna. Procesi ka përfshirë identifikimin e pikave të dobëta të organizatës në rastet e shkeljeve të integritetit dhe vlerësimin e tyre duke marrë parasysh dëmet materiale dhe jo materiale që shkaktojnë shkeljet përkatëse potenciale dhe gjasat që ngjarje të tilla mund të ndodhin duke parë rezistencën aktuale organizative të vërtetuar në rregulloret, procedurat, kodet, praktikat dhe përfshirjen e stafit.

2. Deklarata për Integritet

Ne, në vazhdimësi bëjmë përpjekje të fuqishme për të rritur efikasitetin, trajtimin dhe cilësinë e shërbimeve publike dhe kështu në mënyrë të dukshme dhe të konsiderueshme, përmirësojmë kushtet e jetesës dhe të biznesit për komunitetin lokal.

Ne jemi të vetëdijshëm për mundësitë e sjelljeve keqpërdoruese dhe korruptive, për shkak të fushës së gjerë të ofrimit të shërbimeve dhe të shpenzimeve të buxhetit të planifikuar vjetor. Ekziston një potencial serioz për ushtrim të parregullt të pushtetit të monopolit të cilin ne duhet ta menaxhojmë me llogaridhënie, me përgjegjësi dhe me efikasitet.

Ne gjithashtu e kuptojmë mirë mandatin tonë për ta luftuar korruptionin lokal. Drejtuesit e komunës janë të vendosur të zbatojmë me vendosmëri politikën “zero tolerance” ndaj korruptionit, kur ai zbulohet dhe të sigurojë se korruptioni, mashtrimi, keqadministrimi apo çdo shkelje tjetër e integritetit apo e ndonjë natyre të ngashme nuk do të tolerohet. Të gjitha shkeljet e mundshme do të hetohen, dhe ndaj atyre që janë përgjegjës do të merren masa. Këtu hyjnë edhe ngritja e akuzave penale, veprimet administrative dhe korrigjime sipas nevojës.

Është përgjegjësi e të gjithë stafit tonë që të gjitha incidentet e mashtrimit dhe të korruptionit, apo shkeljet e tjera të integritetit me natyrë të ngashme t'i raportojë tek mbikëqyrësit e tyre. Një tjetër mënyrë raportimi do të bëhet përmes paraqitjes së informacionit përmes mekanizmit të caktuar për paralajmërim. Këto do të trajtohen me konfidentialitetin më të thellë dhe nuk do të zbulohen apo diskutohen me palë të tjera përvëç atyre që janë ngarkuar me hetimin e këtyre raportimeve. Në mënyrë që të sigurohen informata nga burime të ndryshme të mbikëqyrjes së qytetarëve, ne inkurajojmë të gjithë ata që kanë informacione për korruption apo shkeljeve tjera të integritetit, të raportojnë përmes linjën telefonike kundër korruption si një mekanizëm funksional për raportim.

Ne do të bëjmë përpjekje të vazhdueshme të përcaktojmë ekspozimet e mundshme të organeve të administratës komunale, kushteve të tyre organizative, proceseve dhe punonjësve, ndaj korruptionit dhe sjelljeve tjera të paligjshme dhe jo etike. Duke identifikuar rreziqet, planifikimin dhe zbatimin e masave adekuate, ne forcojmë integritetin dhe kulturën kundër-korruption në punën e organeve të administratës komunale. Përmes planit të integritetit, ne eliminojmë shkaqet e korruptionit të cilat mundësojnë forcimin e sundimit të ligjit dhe besimin e qytetarëve në punën e organeve të administratës komunale.

Të gjithë ne jemi përgjegjës për parandalimin efikas, zbulimin me kohë dhe hetimin e korruptionit, mashtrimit apo çdo shkeljeje tjetër të integritetit në komunë. Ne jemi të vendosur që:

- në realizimin e mandatit dhe detyrave tona të veprojmë ndershëm, guximshëm, të matur, moralshëm, drejtë dhe me profesionalizëm.
- të mos përdorim asnjëherë detyrën zyrtare si dhe qasjen e besuar në resurset publike, duke përfshirë qasjen në informata për përfitime personale për ne apo të tjérët, apo për qëllime të avancimit në detyrë.

- të ndërmarrim të gjithë hapat e nevojshëm për të parandaluar dhe zgjidhur çfarëdo konflikti real, të dukshëm apo potencial të interesit ndërmjet përgjegjësive tona zyrtare dhe çështjeve tona private në të mirë të interesit publik.
- të përbahemi nga përfshirja në çfarëdo biznesi apo transaksi apo nga të pasurit e çfarëdo interesit financiar apo interesit tjetër personal, që është apo mund të dalë të jetë në përputhje jo të plotë me kryerjen e detyrave zyrtare.
- të shbangim nepotizmin dhe favorizimin në punësim dhe ofrimin e shërbimeve komunale.
- të përmirësojmë konsiderueshëm politikat tona paranduale të korruptionit duke zbatuar me përpikëri planin e integritetit.
- të përbahemi nga çfarëdo sjellje që mund të humbë vlerën e imazhit të integritetit apo profesionalizmit të komunës

Andaj, unë deklaroj përkrahjen time të plotë dhe përkushtimin tim maksimal për të gjitha përpjekjet që fuqizojnë, zhvillojnë dhe përmirësojnë vazhdimesh sistemin e menaxhimit të integritetit brenda Komunës së Gjakovës.

Kryetari i Komunës

3. Parimet e menaxhimit të Integritetit

3.1 Lidershipi

Menaxhmenti i lartë duhet në mënyrë të dukshme të demonstrojë një përkushtim aktiv të bazuar në fakte për integritetin. Kjo do të kërkonte nga ata që të udhëheqin procesin qysh nga fillimi, përmes zhvillimit të politikave të integritetit. Është shumë e rëndësishme që ky përkushtim të jetë i vazhdueshëm në mënyrë që të kuptohet dhe të shihet mirë nga të gjitha palët e interesit, të jashtme dhe të brendshme.

3.2 Përfshirja e personelit

Është shumë e rëndësishme pjesëmarrja e secilit punëtor në zbatimin e suksesshëm të sistemit për menaxhimin e integritetit. Megjithatë, përfshirja kuptimplotë kërkon

edukimin e përshtatshëm dhe trajnimin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me integritetin, ngritjen e vetëdijes duke krijuar kështu besim dhe mjesdis pozitiv për punë. Komunikimi efektiv i jashtëm dhe i brendshëm dhe koordinimi janë të rëndësishme për punë të suksesshme ekipore në mënyrë që të gjitha palët e përfshira të marrin dhe të mbajnë të njëtin kuptim për projektin derisa është duke u zbatuar.

3.3 Qasja sistemore

Identifikimi i fushave potenciale të korruptionit dhe menaxhimi i proceseve të ndërlidhura për të siguruar integritet kërkon qasje sistemore. Kërkohet nga organizatat që të kushtojnë vëmendje të gjitha komponentëve të sistemit dhe të analizojnë marrëdhënien dhe ndërvarësinë ndërmjet tyre.

4. Objektivat e Planit të Integritetit

Objktivi kryesor i Planit të Integritetit është të rrisë dhe të rendisë përpjekjet dhe burimet për të zvogëluar/eliminuar në mënyrë progresive dhe sistematike shkaqet dhe efektet shkatërruese të korruptionit dhe të sjelljeve jo etike në komunë.

Objektivat specifike janë:

- Sigurimi i një platforme ku të gjithë individët dhe njësitë në komunë si dhe qytetarët mund të përfshihen në luftën kundër korruptionit dhe sjelljeve jo etike në punën e organeve të administratës komunale.
- Krijimi i vetëdijes së publikut mbi rreziqet e korruptionit, sensibilizimi i qytetarëve dhe bizneseve për rolin e tyre në zvogëlimin/eliminimin e korruptionit dhe sjelljeve jo etike.
- Përmirësimi i raportimit të rasteve të korruptionit dhe sjelljeve jo etike në komunë.
- Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve në sektorin publik dhe privat.
- Krijimi dhe mirëmbajtja e partneriteteve në luftën kundër korruptionit dhe sjelljeve jo etike si dhe forcimi i sundimit të ligjit.

5. Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Plani i Integritetit është një dokument që vlerëson ligjshmérinë e punës, integritetin institucional, pajtueshmérinë dhe mënyrën se si institucioni dhe punonjësit e tij veprojnë përmes vetëvlerësimit të ekspozimit ndaj rreziqeve, ndaj ndodhjes dhe zhvillimit të korrupsionit dhe / ose sjelljeve tjera të papranueshme etike dhe profesionale.

Plani i Integritetit kryesisht përbëhet nga:

- Regjistrimi i ceneshmërisë të identifikuar dhe të vlerësuar për të gjitha fushat e funksionimit të komunës.
- Përcaktimi i masave për përmirësimin e integritetit që përshkruan në detaje të gjitha masat që duhet të zbatohen për të zgjedhur ceneshmërinë e integritetit, si dhe afatin kohor përkatës dhe përgjegjësitetë organizative për zbatimin e masave.

Me rastin e zhvillimit të Planit të Integritetit bëhet vlerësimi i ceneshmërisë së integritetit për të gjitha fushat e funksionimit të komunës. Të gjithë të punësuarit kanë pasur mundësi të marrin pjesë në vlerësimin e rrezikut të fushave të funksionimit të komunës dhe të propozojnë masa për të përmirësuar integritetin dhe cilësinë e përgjithshme të menaxhimit si dhe ofrimin e shërbimeve.

5.1 Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit

Zhvillimi i Planit të Integritetit përbëhet prej disa fazave si në vijim:

- *Faza përgatitore* - përfshin themelimin e grupit punues dhe emërimin e koordinatorit për zhvillimin e planit të integritetit; mbledhjen e informacioneve të nevojshme për zhvillimin e planit të integritetit si dhe njoftimin e të gjithë punonjësve për rëndësinë e Planit të Integritetit.
- *Faza e vlerësimit të rrezikut të integritetit* - gjatë kësaj faze koordinatori së bashku me grupin punues analizojnë dokumentacionin e mbledhur (legjislacionin dhe aktet nënligjore të zbatueshme në punën e administratës së komunës; përshkrimet e punës dhe fushëveprimin e çdo njësie komunale) si dhe çdo proces për vendimmarrje dhe ofrimin e shërbimeve. Mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale përcaktohen fushat e rrezikut si dhe identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve.

- *Faza e përcaktimit të prioriteteve, dhe propozimit të masave për përmirësimin e integritetit* - kjo fazë përfshin përcaktimin e prioriteteve për intervenim, përcaktimin e masave për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve dhe përgjegjësit për zbatim
- *Faza e monitorimit dhe raportimit të planit të integritetit* - përfshin monitorimin, vëzhgimin dhe regjistrimin e rregullt të aktiviteteve që ndodhin në një Plan të Integritetit dhe procesin e mbledhjes së informacionit për të gjitha aspektet e zbatimit të Planit të Integritetit. Ndërsa raportimi mundëson që informacionet e mbledhura të përdoren në marrjen e vendimeve për përmirësimin e zbatimit të Planit të Integritetit

5.1 Metodologja e vlerësimit të rrezikut

Vlerësimi i rrezikut do të thotë renditja e rreziqeve më të mëdha në krye të listës, që paraqesin efekte thelbësore në integritetin e komunës dhe mund të rrezikojnë efikasitetin, besueshmërinë dhe imazhin e jashtëm të komunës. Kjo duhet të jetë baza për përcaktimin e masave për trajtimin e rrezikut. Prandaj, prioritetet përcaktohen ashtu që resurset e kufizuara në dispozicion për trajtim, mund të vendosen aty ku vërehet se janë më të nevojshme. Në përgjithësi, rreziqet e kategorizuara si të vogla, përputhen me standarde përmarrje të rrezikut dhe nuk imponojnë nevojën për masa shtesë të trajtimit, por kërkojnë monitorim të efikasitetit të masave ekzistuese të trajtimit/kontrollit. Në anën tjetër, rreziqet madhore kërkojnë trajtim të menjëhershëm me masat adekuate.

Pas përcaktimit të dy parametrave, gjasave të ndodhjes së rrezikut dhe pasojave (ndikimit) të rrezikut të ndodhur, grapi punues duhet të përcaktojë nivelin e rrezikut për të gjitha rreziqet e identifikuara dhe të vlerësuara, duke përdorur Matricën e Rrezikut. Niveli përfundimtar i rrezikut përcaktohet bazuar në Matricën e Rrezikut si kombinim i gjasave dhe pasojave.

7.1.1 Matrica vlerësimit të rrezikut

Matrica e vlerësimit të rrezikut mundëson të llogaritet rreziku në një fushë, aktivitetet e komunës për një kohë shumë të shpejtë, duke identifikuar të gjitha gjërat që mund të shkojnë keq dhe duke peshuar dëmin e mundshëm. Kjo e bën më të lehtë prioritizimin e

çështjeve dhe ndërmarrjen e veprimeve, masave aty ku është më e nevojshme për të mbajtur fushën, aktivitetin e komunës në rrugë të mbarë.

Figura 1 . Matrica e vlerësimit të rrezikut

Pasoja / Ndikimi	Madhor	10									
		9									
		8									
	Mesatar	7									
		6									
		5									
		4									
	Vogël	3									
		2									
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Intenziteti i rrezikut (gjasat X ndikimi)	Ulët			Mesatar			Lartë			Probabiliteti/Gjasat	

Intensiteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabiliteten/gjasën me pasojën/ndikimin duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)", treguar në figurën si më lartë.

7.1.2 Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korruptionit dhe formave të tjera të dëmtimit të integritetit, vlerësohet nga 1 në 100, si në tabelën e më poshtme:

Ulët	Mesatar	Lartë
1 - 15 pikë	16 - 48	49 - 100

█ Rreziku me intensitet të ulët – mundësia e ndodhjes së korruptionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.

 Rreziku me intensitet të mesëm - ndodhja e korruptionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.

 Rreziku me intensitet të lartë - Korrupsioni ose format e tjera të dëmtimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

6. Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës, do të rishikohet periodikisht dhe do të azhurnohet në përputhje me zhvillimet relevante normative, institucionale, procedurale dhe të personelit brenda mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të organizatës. Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në projektim ashtu edhe në funksionim, dhe se procedurat janë kuptuar si dhe plani integriteti është ndjekur.

Gjithashtu monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e riskut kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioriteteve të rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësimet duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen. Raportimi i rregullt, siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur.

Me qëllim të sigurimit të zbatimit të planit të integritetit, krijohen mekanizmat për monitorimin dhe raportimin për zbatimin e Planit të Integritetit, si në vijim:

1. *Menaxheri i Integritetit* - emërohet me vendim të Kryetarit të Komunës (mund të jetë grup punues) dhe është përgjegjës për:

- promovimin e integritetit në komunë dhe merr masa për të parandaluar korrupcionin, konfliktin e interesit dhe format e tjera të sjelljeve jo etike të punonjësve;
- mbajtjen e Planit të Integritetit në pajtim me legjislacionin në fuqi, standardet e punës, metodat e vlerësimit të integritetit dhe me metodat e riparimit;

- zhvillimin e një qasje sistematike, gjithëpërfshtirëse dhe të integruar dhe luftimi në mënyrë proaktive të kërcënimeve ndaj integritetit;
- pranimin dhe rishikimin e informacionit për situatat, ndodhitë dhe veprimet për të cilat ekziston një besim i arsyeshëm se ato përfaqësojnë një mundësi për shfaqjen dhe zhvillimin e korruptionit, konfliktit të interesit dhe formave tjera të sjelljeve jo etike
- propozimin e masave të nevojshme për eliminimin dhe parandalimin e korruptionit, konfliktit të interesit dhe formave tjera të sjelljeve jo etike;
- sigurimin e zbatimit, azhurnimit dhe vlerësimit në bazë të vazhdueshëm të Planit të Integritetit si dhe standarde, format dhe procedurat për të mbështetur PI;
- mbikëqyrjen dhe zbatimin e masave për përmirësimin e integritetit;
- në bashkëpunim me të gjitha njësitë organizative, përgatit raportet për zbatimin e planit të integritetit.
- raportimin mbi zbatimin e Planit të Integritetit.

Menaxheri i Integritetit raporton:

- tek Kryetari i Komunës dhe Drejtoret e Komunës çdo 6 muaj mbi zbatimin e Planit të Integritetit dhe masat përmirësues që duhet ndërmarr nga Drejtoret për periudhën e ardhshme
- pran Asamblesë së Komunës 1 herë në fund të vitit.

2. Koordinatori dhe grupei punues - emërohet me vendim të kryetarit të komunës dhe është përgjegjës për:

- përgatitjen e programit për hartimin e Planit të Integritetit;
- mbledhjen dhe analizimin e dokumentacionit të nevojshëm në lidhje me funksionimin e organeve të komunës, i cili është baza për vlerësimin e rrezikut dhe zhvillimin e Planit të Integritetit-

- konsultohet me grupe relevante të interesit nga sektori publik, shoqëria civile dhe qytetarët me qëllim të mbledhjes së informatave për hartimin e Planit të Integritetit
- harton draftin e Planit të Integritetit dhe prezanton te punëtoret për komente
- finalizon draftin e Planit të Integritetit dhe e dërgon për miratim te Kryetari i Komunës dhe Asambleja Komunale

DRAFT

7. Fushat e rrezikut

7.1 Fushat e përgjithshme të Rrezikut

- 7.1.1 Drejtimi dhe menaxhimi
- 7.1.2 Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve
- 7.1.3 Planifikimi dhe menaxhimi finansiar
- 7.1.4 Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumenteve

7.2 Fushat e veçanta të rrezikut

- 7.2.1 Auditimi i Brendshëm
- 7.2.2 Prokurimi publik
- 7.2.3 Zhvillimi ekonomik lokal
- 7.2.4 Planifikimi urban dhe rural
- 7.2.5 Standardet e ndërtimit dhe kontrolli
- 7.2.6 Inspektimet
- 7.2.7 Arsimi Publik
- 7.2.8 Shëndeti Publik
- 7.2.9 Shërbimet Publike
- 7.2.10 Komunikimi me palë të jashtme të interesit

FUSHAT E PËRGJITHSHME TË RREZIKUT										
Regjistrimi i rrezikut			Vlerësimi dhe matja e rrezikut				Veprimi ndaj rrezikut			
Nr.	Fusha rrezikut	Përshkrimi Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit	
1.	DREJTIMI DHE MENAXHIMI	Objektivat dhe prioritetet e zhvillimit të komunës të paqarta dhe jo transparente si dhe mos përfshirja e të gjitha fushave përkatëse për zhvillimin e komunës në Planin Zhvillimor	Ligjet dhe aktet nënligjore; Raportet periodike ; aktet e brendshme të komunës,	5	9	45	Zhvillimi i metodologjisë për hartimin e Planit Zhvillimor të komunës dhe zbatimin e saj.	Kryetari i Komunës, Kryetari i Kuvendit, drejtuesit e organeve dhe drejtuesit e drejtorive komunale	Deri në tremujorin e fundit 2023	
		Opinion publik negativ dhe humbja e besimit të publikut në punën e administratës komunale dhe Kuvendit Komunal për shkak të transparencës së pamjaftueshme	Plani i Integritetit	2	7	14	Sigurimi i pjesëmarrjes së përfaqësuesve të të gjitha fushave përkatëse si dhe qytetarëve në zhvillimin e Planit Zhvillimor të komunës	Kryetari i Komunës, Kryetari i Kuvendit, drejtuesit e drejtorive komunale		
							Përditësimi i informatave në ueb faqen e Komunës për t'i informuar qytetarët dhe mediat për aktivitetet e komunës	Kryetari i Komunës, Kryetari i Kuvendit, drejtuesit e drejtorive komunale	Në vazhdimësi	
							Informimi i vazhdueshëm i qytetarëve me procedurat për hartimin dhe miratimin e akteve me interes publik me qëllim të përfshirjes së tyre në vendimmarrje	Zyra për Informim në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, Kryesuesin dhe Drejtoritë	Në vazhdimësi	

		Mospërputhja dhe paqartësia e përgjegjësive në administratën komunale		3	8	24	Rishikimi i organizimit të brendshëm të administratës përmes Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.	Njësia e Burimeve Njerëzore	Deri në tremujorin e dytë 2023
		Mos përcaktimi i qartë i përgjegjësive për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Planit të Integritetit		2	6	12	Të përcaktohen përgjegjësítë sa i përket monitorimit dhe raportimit për zbatimin e Planit të Integritetit	Kryetari i Komunës dhe drejtuesit e organeve komunale	Pas miratimit të Planit të Integritetit
		Mos monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e Planit të Integritetit		2	9	18	Të monitorohet dhe raportohet rregullisht zbatimi i Planit të Integritetit	Mekanizmat përkatës të përcaktuara me vendim të Kryetarit të komunës	Çdo tre muaj
							Të rishikohet niveli i zbatimit dhe të përditësohen masat për përmirësimë.	Menaxheri i integritetit, Koordinatori dhe Grupi Punues i integritetit .	Çdo gjashtë muaj tek Kryetari, një herë në vit para Kuvendit
2.	POLITIKA E BURIMEVE NJERËZORE, SJELLJA ETIKE DHE PROFESIONALE E TË	Mos plotësimi i vendeve të punës me staf adekuat dhe të mjaftueshëm	Ligjet, aktet nënligjore; dhe aktet e brendsh	2	7	14	Zhvillimi dhe miratimi i Planit të Personelit	Njësia e Burimeve Njerëzore	Dhjetor të çdo viti
		Profesionalizmi dhe kompetenca e		3	6	18	Zbatimi i parimit të meritës gjatë procedurave të punësimit	Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi

	PUNËSUARVE	pamjaftueshme e të punësuarve.	me të komunës				Të bëhet analiza e nevojave për trajnime	Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive	
							Trajnimi i vazhdueshëm i të punësuarave		
							Të bëhet vlerësimi i ndikimit të trajnimeve të mbajtura		
				2	7	14	Të bëhet rishikimi i detyrave të punës si dhe harmonizimi i tyre me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.	Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve.	Deri në tremujorin e tretë 2023
		Përshkrimet e vendeve të punës të nëpunësve të pa qarta		2	7	14	Të harmonizohen përshkrimet e vendeve të punës me proceset dhe procedurat përkatëse të punës.	Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve	Deri në tremujorin e tretë 2023
				2	7	14	Të ju ri-dorëzohet përshkrimi i vendit të punës të gjithë nëpunësve	Njësia e Burimeve Njerëzore, të gjithë nëpunësit	Deri në tremujorin e tretë 2023
				2	8	16	Monitorimi i zbatimit të obligimeve dhe të drejtave sipas Kodit të Etikës përgjithë zyrtarët komunal përfshirë zyrtarët publik dhe të zgjedhurit dhe të emëruarit	Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi

	Mungesa e informimit dhe sensibilizimit për ekzistencën e kodit të etikës për stafin drejtues dhe stafin tjetër të komunës	1 4	9 6	9 24	Shpërndarja e Kodit të Etikës për të gjithë zyrtaret komunal dhe organizimi i takimeve për informim me përbajtjen e Kodit.	Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi
	Mungesa e informimit dhe mos raportimit të dhuratave nga qytetarët tek punëtorët e Komunës (neni 17 dhe 18 i Rregullore (QRK - Nr. 04/2015 Për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës)	7 8	8 56	56 Të sigurohet mbajtja e takimeve të rrëgullta ndërmjet menaxhmentit dhe personelit për prezantimin dhe diskutimin përmekanizmat e raportimit të korruptionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme brenda institucionit.	Njësisë për Burime Njerëzorë krijon një regjistri për regjistrimin e dhuratave të pranuarav nga nëpunësit; Të informohet stafit përrregullat e pranimit të dhuratave.	Njësia e Burimeve Njerëzore, të gjithë nëpunësit publik	Në vazhdimësi
	Niveli i pamjaftueshmëri i ndërgjegjësimit të punonjësve përraportimin e korruptionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme brenda institucionit.	7 8	8 56	56 Të sigurohet mbajtja e takimeve të rrëgullta ndërmjet menaxhmentit dhe personelit për prezantimin dhe diskutimin përmekanizmat e raportimit të korruptionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme.	Njësia e Burimeve Njerëzore, Kryetari i Komunës dhe Kuvendit dhe drejtuesit e dreitorive	Njësia e Burimeve Njerëzore, Kryetari i Komunës dhe Kuvendit dhe drejtuesit e dreitorive	Në vazhdimësi

					Të gjithë nëpunësit publik të punësuar dhe ata të cilët do të rekrutohet, të nënshkruajnë deklaratën e integritetit në bazë të secilës nëpunësi do të merr përgjegjësin përkatëse	Njësia e Burimeve Njerëzore, të gjithë nëpunësit publik	Në vazhdimësi	
3. PLANIFIKIM I DHE MENAXHIMI I BUXHETIT DHE FINANCAVE	Planifikimi jo adekuat i buxhetit vjetor komunal.	Ligjet, aktet nënligjore; dhe aktet e brendshme të komunës	2	7	14	Të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha palëve relevante gjatë planifikimit të buxhetit;	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Në vazhdimësi
						Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive përkatëse për personelin për planifikim të buxhetit	Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa	
	Shpenzimi i buxhetit jo në mënyrë adekuate dhe jo mjaftueshëm transparent	Hartimi dhe miratimi i planit të shpenzimeve	2	7	14	Hartimi dhe miratimi i planit të shpenzimeve	Kryetari i Komunës dhe drejtoria për buxhet dhe financa	Pas aprovimit të buxhetit vjetor
						Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	
						Publikimi i planit të shpenzimeve në ueb faqen e komunës	Njësia për informim	
						Të sigurohet mbikëqyrja e mbi zbatimin e buxhetit nga KPF	Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe KPF	
						Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore dhe realizimin e buxhetit	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	

		Inventarizimi dhe regjistrimi joefikas i aseteve komunale		5	6	30	Të përditësohet regjistri i brendshëm i aseteve të komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Deri në tremujorin e dytë 2023	
4.	RUAJTJA DHE SIGURIA E TË DHËNAVE DHE DOKUMENTACIONIT	Siguria e pamjaftueshme e të dhënave në sistemet e teknologjisë informative si dhe përdorimi i tyre për qëllime jozyrtare	Ligjet, aktet nënligjore; dhe aktet e brendshme të komunës.	4	9	36	Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së punës për proceset që realizohen përmes sistemeve të teknologjisë informative	Kryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës dhe sektori i TIK	Në vazhdimësi	
		Trajtimi jo adekuat i dokumentacionit zyrtar dhe informacionit		3	8	24	Të sigurohet informimi për të gjithë të punësuarit lidhur me rrezikut nga mashtrimet dhe korrupsioni që kanë të bëjnë me sigurinë e informacionit dhe shfrytëzimin e të dhënave të kompjuterizuara	Drejtoria e Administratës dhe sektori i TIK	Në vazhdimësi	
FUSHAT E VEÇANTA TË RREZIKUT										
Regjistrimi i rrezikut			Vlerësimi dhe matja e rrezikut			Veprimi ndaj rrezikut				

Nr.	Fusha rrezikut e	Përkrimi Rrezikut i	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasa t	Ndikimi	Vlerësimi rrezikut i	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
1.	AUDITIMI I BRENDSHËM	Mungesa e planifikimit të auditimit të bazuar në rrezik dhe auditimeve rast pas rasti	Ligjet, aktet nënligjore; dhe aktet e brendshme të komunës	2	8	16	Të sigurohet planifikim efektiv i auditimit i bazuar në rezultatet e vlerësimit të rrezikut dhe të monitorohet zbatimi i këtij plani si dhe të planifikohen masa përmirësuese në rast nevoje. Të sigurohen auditime rast pas rasti për të vërtetuar të gjeturat gjatë inspektimeve	Kryetari i Komunës, Komisioneri i auditimit, Njësia e auditimit	Në vazhdimësi
		Mungesa e mbikëqyrjes adekuate, profesionale mbi zbatimin e rekomandimeve		3	9	27	Zhvillimi i një plani për zbatimin e rekomandimeve të auditimit Raportim i rregullt mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit	Kryetari i Komunës	Në bazavjetore
		Mungesa e koordinimit ndërmjet Njësisë së AB, Komisionit të Auditimit dhe Kryetarit		3	8	24	Të përmirësohet sistemi i komunikimit mes njësisë së auditimit të brendshëm dhe organeve të tjera komunale.	Kryetari i Komunës, Njësia e AB, Komisioneri i Auditimit	Në vazhdimësi
		Mungesa kapaciteteve		6	9	54	Rekrutimi i stafit të mjaftueshëm për	Njësia e Burimeve Njerëzore	Deri në tremujorin

		njerëzore brenda Njësisë së Auditimit					funksionimin adekuat të Njësisë së Auditimit		e parë 2023
2.	PROKURIMI PUBLIK	Përgatitje joefikase e specifikimeve të tenderit	Ligjet, aktet nënligjore; dhe aktet e brendshme të komunës	6	9	54	Rritja e kapaciteteve për përgatitjen e specifikimeve të tenderit duke marrë parasysh kriteret për mos-diskriminim dhe duke siguruar qasje të barabartë. Dhe	Njësia e prokurimit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi
		Mos transparenca dhe mbikëqyrja e pamaftueshme e prokurimit publik		3	8	24	Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive përkatëse për personelin për prokurimin publik	Njësia e prokurimit dhe Njësia e Burimeve Njerëzorë	Në vazhdimësi
							Publikimi i Planit të Prokurimit në ueb faqen e komunës	Njësia e prokurimit	Pas miratimit të planit të prokurimit
							Të caktohen auditime pas prokurimit dhe dhënies së kontratës për tenderë për të rishikuar respektimin e standardeve të specifikuara procedurale	Kryetari i Komunës, Njësia e Auditimit të Brendshëm.	Në vazhdimësi
							Të kufizohen mundësitë për komunikim me ofertuesit duke krijuar protokoll të qartë për komunikimin me ofertuesit dhe duke krijuar pikë të qarta të kontaktit	Kryetari i Komunës dhe Njësia e prokurimit	Në vazhdimësi

		Menaxhimi joefikas i kontratave/projekteve		7	9	63	Krijimi i Sektorit për Menaxhimin e Projekteve dhe Trajnimi i personelit për menaxhimin e kontratave/projektit	Kryetari i Komunës, Kuvendi Komuna, Njësia e prokurimit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi
3.	ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL DHE BUJQËSIA	Mungesa apo mos rishikimi dhe përditësimi i dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik lokal	Ligjet, aktet nënligjore; dhe aktet e brendshme të komunës	4	9	36	Hartimi, rishikimi dhe përditësimi si dhe miratimi i dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik të komunës	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	Deri në tremujorin e Dytë 2023
		Qëllimet dhe prioritetet e zhvillimit ekonomik të komunës të paqarta dhe jo-transparente.		6	8	48	Rishikimi i prioriteteve të zhvillimit ekonomik të komunës Të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha palëve relevante gjatë hartimit dhe caktimit të prioriteteve të zhvillimit komunal.	Kryetari i Komunës, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	Deri në tremujorin e katërt 2023
		Kritere jo të qarta dhe transparencë e pa mjaftueshme në ndarjen e subvacioneve për zhvillim e bujqësisë dhe sektorëve tjera		1	9	9	Të zhillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere dhe procedura të qarta për ndarjen e subvacioneve dhe për të parandaluar vendime arbitrale dhe praktika korruptive Pjesëmarrja e shoqërisë civile në vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvacioneve	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	Në baza vjetore

		Kualifikimi i pamjaftueshmëri personelit për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dokumenteve për zhvillimin ekonomik lokal		3	9	27	Të sigurohet personel adekuat profesional për zhvillimin ekonomik lokal Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e zhvillimin ekonomik lokal	Kryetari i Komunës; Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi
4. PLANIFIKIM I URBAN DHE RURAL		Mangësi në rregullativen e brendshme që lidhet me fushën e planifikimit urban dhe rural	Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës dhe planet rregullative urbane	4	9	36	Hartimi, miratimi dhe zbatimi i Planit Zhvillimor dhe të Hartave Zonale	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Kryetari i Komunës,	Deri në tremujorin e dytë 2023
		Zbatim jo i plotë i rregullatives së brendshme që lidhen me fushën e planifikimit urban dhe rural		5	9	45	Të rritet mbikëqyrja e zbatimit të rregullatives së brendshme Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	
		Mbikëqyrja jo efikase mbi zbatimin e aktiviteteve të planifikimit urban dhe rural		5	8	40	Kontrollimi dhe raportimi i rregullt për zbatimin e aktiviteteve të planifikimit urban dhe rural	Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	

5.	STANDARD ET NDËRTIMIT DHE KONTROLI	Mungesa e kontolleve konsistente mbi ndërtimet (vendi punishtet)	Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendsh me të komunës dhe planet rregullative urbane	7 3	9 10	63 30	Shtimi i kontolleve në vendet e ndërtimit, me qëllim të ndalimit me kohë të ndërtimeve pa leje.	Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	Në vazhdimësi
		Mungesa e stafit adekuat përe k Kontrollimin ndërtimeve					Të sigurohet personel adekuat profesional për planifikim urban dhe rural	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	Deri në tremujorin e dytë 2023
							Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi
6.	INSPEKTIME T	Mungesa e planifikimit të duhur të inspektimeve	Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendsh me të komunës	3 5	7 8	21 40	Të sigurohet plani vjetor i inspektimeve për çdo fushë duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut.	Drejtoria për Punë Inspektuese	Në vazhdimësi
		Mungesa e kapaciteteve profesionale të inspektorëve					Organizimi i trajnimeve profesionale për inspektoret	Drejtoria e inspektiveve, Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi
		Numër i pamjaftueshëm i inspektorëve		3	8	24	Të sigurohet numër i mjaftueshëm i inspektorëve nga personeli i brendshëm i komunës ose punësime të reja	Drejtoria e inspektiveve, Njësia e Burimeve Njerëzore	Deri në tremujorin e katër 2023
7.	ARSIMI PUBLIK	Planifikimi i shërbimeve arsimore jo adekuat dhe i paefektshëm	Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendsh	3	9	36	Të sigurohet planifikim i shërbimeve arsimore bazuar në nevojat aktuale	Drejtoria e Arsimit	Deri në tremujorin e tretë 2023

		Inspektimet e pa të mjaftueshme procesit mësimor	me të komunës	3	8	24	Të hartohet plani i inspektimeve dhe mbikëqyrja e zbatimit të tij	Drejtoria e Arsimit	Në vazhdimë si
8.	SHËNDETI PRIMAR	Hapësira dhe Infrastruktura shëndetësore o efikase në ofrimin e shërbimeve shëndetësore.	Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës	5	7	35	Rishikimi dhe revidimi i prioriteteve përmirësimë në infrastrukturë dhe sigurimin e hapësirave të nevojshme për shërbime shëndetësore.	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	Në vazhdimë si
		Mangësi në rregullativen e brendshme lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe zbatimi jo i plotë i saj	si dhe planet dhe strategjitet e në shëndetësi	3	9	36	Të rishikohet rregullativa e brendshme me qëllim të përmirësimit dhe plotësimit.	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	Deri në tremujorin e dytë 2023
							Të shtohet kontrolli i zbatimit të rregullatives.	Drejtoria për Shëndetësi dhe drejtuesit e institucioneve shëndetësore	Në vazhdimë si
9.	SHËRBIMET PUBLIKE	Efikasitetit, efektivitetit, cilësia dhe transparencës jo e kënaqshme në ofrimin e shërbimeve publike	Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës si dhe planet dhe strategjitet e në	5	8	40	Të zhvillohen aktet nënligjore si dhe qartësimi i procedurave për lejet për shërbimet përkatëse publike.	Drejtoria përkatëse për shërbime publike dhe licencimin e tyre	Në vazhdimë si
							Të krijohen aplikacione elektronike për shërbimet publike që mund të ofrohen në mënyre elektronike apo të ofrohen ato shërbime përmes platformës E-KOSOVA	Drejtoria për Administratë dhe njësia e TIK-ut	Në vazhdimë si

			shëndetësi				Të zvogëlohet mundësia e kontakteve mes palëve të interesuara dhe zyrtarit që merr vendim (vendimi të merret nga zyrtari profesional, ndërsa pagesa dhe dërgimi i vendimit të bëhet në zyrat pritëse nga zyrtari tjeter	Mbikëqyrësi i shërbimeve publike	Në vazhdimësi
							Të rritet profesionalizmi i stafit përmes trajnimeve, shkëmbimit të përvojave, punëtorive	Drejtoria përkatëse për Shërbime Publike dhe Njësie e Burimeve Njerëzore	
10.	KOMUNIKI MI ME PALË TË JASHTME TË INTERESIT	Mungesa e transparencës dhe konsultimeve me palë të jashtme të interesit gjatë hartimit të rregulloreve dhe buxheteve komunale	Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës	2	8	16	Të rritet transparenca dhe të merren masa për konsultime me palë të jashtme të interesit gjatë zhvillimit të rregulloreve komunale dhe të buxhetit (postimi i projekt-rregulloreve në ueb faqe, iniciimi i diskutimeve publike, fokus grupe etj.)	Zyra për Informim	Në vazhdimësi
		Mungesa e partneritetit me shoqërinë civile në fushën e anti-korrupsionit dhe bashkëpunimit me komunitetin e bizneseve		5	9	45	Të zhvillohen partneritete me shoqërinë civile në fushën e anti-korrupsionit duke themeluar grupe pune teknike përmenaxhimin e riskut në fushat e ndjeshme dhe të brishta ndaj korrupsionit		

						dhe të sigurohet përfshirja e OJQ-ve.		
						Të forcohen mekanizmat e konsultimeve me bizneset përmes takimeve periodike konsultative		
						Të rritet rrjedha e informacionit drejt medias dhe publikut lidhur me parandalimin e korruptionit dhe të aktiviteteve të luftës kundër tij.		